



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-039

Prishtinë, më 19 tetor 2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 DHE 20 TETOR
2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Driton Lajçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës.

* * *

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 29 shtator dhe më 5,8 dhe 14 tetor 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Presidentja e vendit, znj. Atifete Jahjaga, e ka ndërmarrë një iniciativë për komunikim me subjektet politike për të gjetur zgjidhje për funksionalizimin e Kuvendit.

Kryetari propozoi që mbledhja e Kryesisë të shtyhet për nesër, më 20 tetor 2015, në orën 11:00.

Kryesia e miratoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit.

Në fund, kryetari tha se rendi i ditës për mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit që do të mbahet nesër mund të plotësohet edhe me ndonjë pikë tjetër, që i plotëson kushtet për shqyrtim.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

E martë, 20 tetor 2015, ora 11:00

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,
Nga OSBE-ja: Floriana Shala,
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe
Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

* * *

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës.

* * *

Kryetari i njoftoi të pranishmit se pikat e rendit të ditës së seancës plenare, e filluar më 15 tetor 2015, janë si në vijim:

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin mendor,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,*
- 6. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,*
- 7. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,*
- 8. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore,*
- 9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb,*
- 10. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.*

Pastaj, kryetari hapi diskutimin lidhur me vazhdimin seancës plenare, e ndërprerë më 15 tetor 2015.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, propozoi mbledhja të shtyhet për pasdite, ngase presidentja Atifete Jahjaga është duke u konsultuar me partitë opozitare lidhur me zhbllokimin e Kuvendit.

Gjithashtu, edhe nënkryetarja e Kuvendit, znj. Duda Balje, e mbështeti propozimin e nënkryetarit Xhavit Haliti.

Kryetari e shtyu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për në orën 14:30 min.

E martë, 20 tetor 2015, ora 14:30
Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë

Kryetari propozoi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të premtën, më 23 tetor 2015, në orën 16:00.

Kryesia e miratoi propozimin e kryetarit që seanca plenare, e ndërprerë më 15 tetor 2015, t'i vazhdojë punimet më 23 tetor 2015, në orën 16:00, me pikat e rendit të ditës të shënuara më lart.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 14:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale